



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:003310

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05756499

**AC-I-23-0023**

***Në ankesën e***

**Paditësi/Ankuesi**

**U H**, fshati H.

***kundër***

**E paditura**

**NSH Amortizatorët**(në likuidim),Prishtinë, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha" nr.55,Lakërishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-4732 të datës 10 janar 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 30 maj 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet e pa bazuar .**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-14-4732 i datës 10 janar 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me 17 qershor 2014, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN047-1158 të datës 23 maj 2014, me të cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës në shumë prej 1.540,00 euro nga NSH "Fabrika e Amortizatorëve" (në likuidim), me arsyetimin se kërkesa nuk është e bazuar në bazë të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Ankuesi pohoi se e kundërshton vendimin e AL për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Më tej, paditësi pohoi se ka qenë në marrëdhënie pune për periudhë të pacaktuar kohore tek e paditura e parë NSH "Fabrika e Amortizatorëve" në Prishtinë dhe atë përfundimisht deri me datën 01 dhjetor 2011 dhe se me aktnjoftim është njoftuar se "duke filluar nga data 01 dhjetor 2011 e tutje, paditësit si dhe të gjithë punonjësit tjerë të kësaj ndërmarrje shoqërore u ndërpriten kontratat e punës dhe të njëjtëve edhe u shkëputet marrëdhënia e punës". Paditësi nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij në ankesë. Paditësi me ankesë kundër Vendimit të AL, tani kërkon kompensimin për paga të pa paguara për periudhën nga 01 dhjetori 2011 deri më 5 korrik 2013, në shumë të përgjithshme prej 4,180.00 ( katër një tetë zero) Euro. Paditësi konsideron se AL ka bere shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit të punës, sepse sipas padisë konsiston për faktin se AKP nuk e ka njoftuar sindikatën e NSH, lidhur me largimin kolektiv, edhe përkundër faktit se NSH ka pasur asete tjera jo te privatizuar të cilat kanë gjeneruar të ardhura. Nga ky fakt sipas paditësit i është shkaktuar dëm dhe atij dhe atij dëm, në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve duhet ti kompensohet.

Pranë DHPGJS, nga ana e Sindikatës së pavarur së NSH janë parashtruar deklaratat e punëtoveve, me të cilën shihet pëlqimi i tyre që përfaqësuesit të ndërmarrin të gjitha veprimet lidhur me realizimin e kërkesave kreditoreve-pagave të pa paguara. Në këtë grup të deklaratave është parashtruar edhe deklarata e paditësit, U H dhe adresa e tij (në tekstin në vijim DEKLARAT).

Me 19 prill 2022, e paditura AKP-parashtroi mbrojtje, në të cilën pohoi se AL ka bërë një vlerësim të drejtë të gjendjes faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar

saktësisht. E paditura pohoi se lista e pagave prej muajit maj 2010, pra 11 muajt e fundit para 31 mars 2011, kur është kryer privatizimi i ndërmarrjes, e paraqitur nga menaxhmenti i NSH, nuk pasqyron ndonjë pagesë të kryer ndaj ankuesit të kërkesës.

AKP tutje pohoi se kërkesa kreditore, në pajtim me dispozitat ligjore të ligjit mbi punën e bashkuar- LPB, është parashkruar. AKP përfundimisht pohoi se paditësi nuk ka qenë punëtor aktiv i NSH në momentin e privatizimit të saj. Nga të gjitha AKP propozojë që padia të hedhet poshtë si e pa pranueshme ose te refuzohet si e pa bazuar dhe te vërtetohet Vendimi i AL. Përgjigjes ja ka bashkangjitur: kopjen e vendimit të AL, PRN047-1158 datë 23 maj 2014 sipas të cilit kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje te parakohshme të marrëdhënies së punës në shumë 1,540.00 ( një pesë katër zero) euro, ndaj NSH" Amortizatorët", është refuzuar dhe kopjen e Vendimit mbi emërimin e anëtareve të AL.

Përgjigja e AKP, me anë të urdhrit të gjykatës, ju dorëzuar paditësit më 5 maj 2022, i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje.

Me 10 janar 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-4732, ankesën e paditësit e ka refuzuar si të pa bazuar, e ka vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN047-1158 datë 23 maj 2014, dhe nuk caktohen shpenzime gjyqësore. Në arsyetim të aktgjykimit thuhet se me kërkesë për rishikim e vendimit të AL, i cili atakohet, nuk mund të kërkohet një kërkesë tjetër kreditore ndaj asaj që AL ka vendosur. Në rastin konkret paditësi kërkon kompensim, e cila kërkesë nuk ishte objekt i shqyrtimit pranë AL. Kërkesa për kompensimin për paga të pa paguara si dhe kompensimit si rezultat i shitjes, privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP-së duke u bazuar në nenin 40 të shtojcës së Ligjit për AKP janë dy kategori të caktuara dhe të ndara nga njëra tjetra. Lidhur me pagat e pa paguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të Shtojcës së ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.6.2 parashihet: a. Përbushje e kërkesave për pagat e punonjëseve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto si person, si dhe b. E drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerjen të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes

apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në.

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të shtojcës së Ligjit për AKP, parashihet përmbushja e kërkesave siç janë :“ kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet të lartë”

Shkalla e I-rë ka arsyetuar se nga dispozitat e lartcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse :

- a. Pagat e punonjësit, në këtë rast paditësit, nuk janë paguar.
- b. Kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit të saj,
- c. Pushimi mbi punën ka ardhur si pasoje si pasojë e Vendimit të AL dhe
- d. Ndonjë veprim nga Agjencia lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes likuidimit etj.

Shkalla e I-rë ka theksuar se Ligji për AKP me Shtojcën e saj konsiderohet ligj i veçantë ( *lex specialis*) që rregullon edhe procedurën e likuidimit të NSH si edhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e NSH ndaj punëtoreve dhe anasjelltas e në pajtim me dispozitat tjera ligjore në fuqi. Në rastin konkret referenca e paditësit në dispozitat e ligjeve tjera, të cilat i konsideron si shkelje, gjykata i konsideron si te pa bazuara dhe të argumentuara e që do të tregonin arsyet e shkeljeve të cilat AL i ka bërë ë procedurën e shqyrtimit të kërkesave.

Shkalla e I-rë kishte ardhë në përfundim se paditësi nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi kompensimin siç edhe parashihet sipas nenit 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.7 por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Me 18 janar 2023, paditësi/ ankuesi për mes postës e dërgoi në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-4732 të datës 10 janar. Paditësi me ankesë ka kërkuar që të priset Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim. Paditësi tutje ka theksuar se në këtë çështje ka ofruar provat relevante të cilat dëshmojnë se NSH“ Amortizatorët” e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit-AK në Prishtinë, nuk i ka paguara pagat për ndërprerje të parakohshme të punës në shumë prej 1,540.00 euro. Paditësi në ankesë ka theksuar se i është refuzuar kërkesa për rishikim- ankese kundër vendimit të AKP-

së me numër si me lartë të AL me të cilin ka kërkuar pagat e pa paguara për periudhën 1 dhjetor 2011 deri më 5 korrik 2013 në shumë prej 4, 180.00 euro, për të cilat gjykata nuk ka shqyrtuar shkresat e lendes nga të cilat do të vinte në përfundim se ankesa e palës ankuese – paditëse do të aprovohej në tersi si e bazuar dhe ta detyroje palën kundërshtare – e paditur që t’ia kompensojë pagat e pa paguar për periudhën kontestuese. Ka shtuar se gjykata gjatë procedimit dhe shqyrtimit të çështjes është bazuar në tersi në vendimin e nxjerrë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit AKP-së PRN 047-1158 datë 23 maj 2014, duke e vërtetuar si të ligjshëm në bazë të cilit parashtruesit të kërkesës i është refuzuar kërkesa me të cilin ka kërkuar pagat e pa paguara.

Me 14 shkurt 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtrësë dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. Në këtë parashtrësë AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore të paditëses duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj, dhe e mbështet Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë, duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Tutje AKP-ja pohon se ankuesi nuk ka paraqitur fakte dhe prova materiale dhe as bazën juridike as për padinë dhe as për ankesën, andaj ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit e datës 19 gusht 2013, për kompensimit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nga NSH "Amortizatorët", në shumë prej 1,540.00 euro, ishte refuzuar nga ana e Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se paditësi rezulton të mos ishte punëtor aktiv në momentin kur NSH- hyri në likuidim.

Paditësi kishte paraqitur ankesë kundër vendimit të AL PRN047-1158 të datës 23 maj 2014. Shkalla e I-rë me Aktgjykimin C-IV.-14-4732, të datës 10 janar 2023, ankesën e paditësit e ka refuzuar si të pa bazuar, dhe ka vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN047-1158 datë 23 maj 2014 me arsyetimin se paditësi nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi kompensimin siç edhe parashihet sipas nenit 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 , 1.6.2 dhe 1.7 por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Paditësi me ankesën e parashtruar në Kolegjin e Apelit edhe me tutje pretendon se ai ka parashtruar dhe ofruar provat relevante të cilat dëshmojnë se NSH "Amortizatorët", nuk i ka paguara pagat për ndërprerje të parakohshme të punës në shumë prej 1,540.00 euro. Po ashtu paditësi në ankesë ka theksuar se atij i është refuzuar kërkesa për rishikim- ankese kundër vendimit të AKP-së me të cilin ka kërkuar pagat e pa paguara për periudhën 1 dhjetor 2011 deri më 5 korrik 2013 në shumë prej 4,180.00 euro, për të cilat gjykata nuk ka shqyrtuar shkresat e lëndës.

Kolegji i Apelit pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe pretendimet e paditësit, vlerëson se Shkalla e I-rë me të drejtë ka konstatuar se me kërkesë për rishikim e vendimit të AL, i cili atakohet, nuk mund të kërkohej një kërkesë tjetër kreditore ndaj asaj që ka vendosur AL. Objekt kontesti i kësaj çështje ishte vetëm vendimi i kundërshtuar i AL PRN047-1158 i datës 23 maj 2014, lidhur me kërkesën për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shume prej 1,540.00 euro. Paditësi me ankesë e ka kundërshtuar vendimin PRN047-1158. Pretendimet e ankuesit/ paditësit të ngritura me ankesë në Shkallë të I-rë dhe të II-të për pagat e pa paguara për periudhën 1 dhjetor 2011 deri më 5 korrik 2013 në shumë prej 4,180.00 euro, nuk mund të shqyrtohen në këtë procedurë, pasi që nuk kanë qenë objekt shqyrtimi pranë AL dhe nuk janë trajtuar

në vendimin e kundërshtuar PRN047-1158, prandaj perëndimet e paditësit në këtë aspekt janë të pabazuara.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë ku ka është theksuar se Ligji për AKP me shtojcën e saj konsiderohet ligj i veçantë ( *lex specialis*) që rregullon edhe procedurën e likuidimit të NSH si edhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e NSH ndaj punëtorëve dhe anasjelltas e në pajtim me dispozitat tjera ligjore në fuqi.

Në rastin konkret paditësi përveç perëndimeve nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi për të mbështetur pretendimin e tij.

Paditësi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se ka qenë punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit për likuidim të NSH "Amortizatorët",,, apo se marrëdhënia e punës i ka pushuar si pasojë e ndonjë veprimi të ndërmarrë nga AKP-ja. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e paditësit lidhur me të drejtën e tij, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla refuzohen si të pabazuara.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e paditësit refuzohet dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së I-rë si, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore:**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 20 euro me datë 12 prill 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 30 maj 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues \_\_\_\_\_